



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.11.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E LIPJANIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Mirlinda Beqiri* Udhëheqës i Ekipit dhe *Ejup Simnica, Besim Lezi, Elvir Krasniqi* Anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Luljeta Morina*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	22
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Letër Konfirmim	32

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 28/09/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Lipjanit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pagesat për mësimdhënësit në vlerë prej 187,900€, si pasojë e vendimeve gjyqësorë janë paguar dhe regjistruar si shpenzime nga investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, duke u prezantuar në PVF si keq klasifikim i shpenzimeve. Gjithashtu ishin keq klasifikuar edhe shpenzimet në vlerë 38,505€ të cilat ishin buxhetuar dhe prezantuar gabimisht si subvencione respektivisht investime kapitale edhe pse i takonin kategorive tjera.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë, Komunës, Agjencisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna në PVF ka prezantuar shpenzime në kategoritë ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Gjatë vitit 2018, nga Ministria e Financave janë ekzekutuar pagesa bazuar në vendimet gjyqësore në vlerë prej 595,390€. Prej tyre 187,900€ janë shpenzime që janë klasifikuar gabime si pasoje e pagesave për pagat përcjellëse për mësimdhënësit që dalin në pension, ndërsa pjesa tjetër vlerësohet të jetë klasifikuar drejt. Si pasojë e mos planifikimit të buxhetit për mbulimin e

obligimit të këtyre pagave ato janë ekzekutuar nga kategoritë tjera (nga investimet kapitale në vlerë prej 83,710€, si dhe nga mallrat dhe shërbimet në vlerë 104,189€). Kjo ka shkaktuar mbivlerësim e një kategori dhe nënvlerësimin e kategorisë tjetër ekonomike. Përkundër regjistrimit dhe pagesës në kategori jo adekuate, këtë gjendje komuna e ka shpalos për publikun në PFV.

- Planifikimi dhe menaxhimi jo i duhur i shpenzimeve ka shkaktuar mbivlerësim të shpenzimeve në kategorinë e investimeve kapitale në vlerë 4,521€ duke paguar pajisje në vlerë nën 1000€ si dhe të subvencioneve në vlerë prej 33,984€, për shkak se komuna ka zhvilluar proceduar të prokurimit dhe ka ofruar mallra apo kapital për përfituesit. Opinioni jonë nuk është modifikuar për këto çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se në kuadër të prezantimit të llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 4.35 milionë € apo rreth 10% me shume se vitin paraprak, përfshihen edhe të arkëtueshmet e bartura prej më shumë se pesë vitesh (LLA për taksat për leje afariste në vlerë 0.5 milion €) ku mundësia e arkëtimit të tyre është minimale. Gjithashtu duke u nisur nga fakti se rreth 79% të llogarive të pa mbledhura e përbejnë të arkëtueshmet e tatimit në pronë (të cilat kanë shënuar rritje prej 13%), komuna rrezikon financimin e projekteve që synon nga këto fonde në të ardhmen dhe vjetërsimi i disa llogarive të akumuluar vite më parë, zvogëlon mundësin e inkasimit të këtyre llogarive. Sa i përket llogarive të qirave dhe taksive nuk ekzistojnë shpalosje të mjaftueshme që mund të konsideroheshin për nevoja të planifikimeve buxhetore të burimeve vetjake.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Ligji për financat e pushtetit lokal Nr. 05/L -108 dhe plotësim ndryshimi Nr. 03/L-049;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportet e rregullta tremujore për Kuvendin Komunal dhe diskutimi i raporteve të AB-së dhe ZKA-së nga KK;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet mujore dhe tremujore, raportet operative (të performancës); dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);

Lidhur me PFV-ve, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë në vijim:

- Neni 16, Raporti për llogarit e arkëtushme, për qiratë dhe taksitë janë nënvlerësuar për 1,725€ (qiratë 135€ dhe llogaria e taksive për 1,590€);

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, ndonëse ekzistojnë gabime të shpalosjet të cilat nuk kanë ndikuar në opinionin e auditimit.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël dhe të ofrohen shpalosje të sakta për llogarit e arkëtueshëme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave vazhdojnë të mbeten fusha më shqetësuese, duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe mos realizim të projekteve sipas kushteve të kontraktuara. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat pjesërisht janë të përshtatshme dhe kontrollet mbi njësrëfushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, klasifikimi dhe menaxhimi i shpenzimeve, menaxhimi i të hyrave, llogarive të arkëtushëm dhe subvencioneve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	14,025,258	16,183,151	14,903,408	13,742,820	13,172,294
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,916,711	13,472,369	13,352,789	11,687,679	11,503,444
Të bartura nga viti paraprak ²	-	470,745	330,177	590,347	453,645
Të hyrat vetjake ³	2,108,547	1,936,601	1,189,232	1,383,836	1,137,530
Donacionet e brendshme	-	248	-	-	5,000
Donacionet e jashtme	-	113,013	-	80,958	72,675
Financimi nga huamarrja	-	190,175	31,210	-	-

Komuna nuk kishte arritur ta aprovoj me kohë buxhetin e vitit 2018 për shkak të problemeve në asamble, duke bërë kështu që buxheti fillestar të jetë i njëjtë me buxhetin e vitit paraprak – 2017.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetiake.

Vetëm pas konstituimit të kuvendit të ri, me datë 18.12.2017 është bërë aprovimi i buxhetit të ri që pasqyron lëvizjet përkatëse.

Gjithashtu në buxhetin final janë të përfshira edhe të hyrat e bartura nga viti paraprak, në vlerë prej 470,745€, donacionet e brendshme dhe të jashtme në vlerë 113,261€ si dhe financimi nga huamarrja në vlerë 190,175€.

Në vitin 2018, Komuna e Lipjanit ka shpenzuar 92% të buxhetit final ose 14,903,408€, menjënormë të njëjtë sikurse në vitin 2017. Megjithatë, realizimi i buxhetit në disa kategori mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	14,025,258	16,183,151	14,903,408	13,742,820	13,172,294
Pagat dhe Mëditjet	8,772,802	9,095,983	9,036,804	8,650,049	8,711,706
Mallrat dhe Shërbimet	856,366	1,371,442	1,144,789	894,469	881,580
Shërbimet komunale	198,390	217,538	210,403	197,440	179,045
Subvencionet dhe Transferet	329,067	404,996	336,750	259,094	375,763
Investimet Kapitale	3,868,633	5,093,192	4,174,662	3,741,768	3,024,200

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 82% e buxhetit është shpenzuar. Programi për Investime Publike përfshin disa projekte në vazhdim nga viti i kaluar por edhe projekte të reja për vitin aktual. Megjithatë, vonesat në zbatim janë gjithashtu të dukshme në disa projekte të filluara para vitit 2018.
- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje dhe për mallra dhe shërbime është rezultat i rritjes së pagave prej 4%. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshin gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm si dhe nga donatorët e jashtëm. Buxheti për kategorinë e pagave ishte shpenzuar në normën prej 99% ndërsa për mallra 83%.
- Komuna e Lipjanit ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në vlerën 113,013€, të cilat ishin alokuar për investime kapitale kryesisht për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, për projektet “Ndërtimi i pajisjeve sinjalizuese në Qytet” si dhe “Ndërtimi i qendrës informuese turistike”. Komuna nuk kishte lidhur kontratat ende për këto projekte dhe fondet e fituara nga donatorët nuk janë shpenzuar gjatë këtij viti.
- Edhe financimi nga huamarrja ishte i orientuar në shëndetësi dhe arsim 20,243€ ishin shpenzuar nga investimet kapitale përkatësisht projekti “Blerja e Pajisjeve tjera dhe teknologjisë informative në shkollë si dhe 10,9667€ janë realizuar nga mallrat dhe shërbimet për shërbime kontraktuese tjera.

Çështja C2⁴ - Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale

Gjetja Buxheti total i komunës është realizuar në normën 92%, ndërkohë sfida mbetet realizimi jo i kënaqshëm i buxhetit për investime kapitale në 82%, dukë rezultuar me mundësinë apo rrezikun që disa nga objektiva e përcaktuara të komunës të mos arrihen, dhe si të tilla ngarkojnë fondet buxhetore të vitit vijues. Nëse kemi parasysh edhe shpenzimet përmes vendimeve gjyqësore nga kjo kategori (shih theksimin e çështjes tek opinionin e auditimit) konsiderojmë që norma e realizimit të buxhetit për investime kapitale është në nivel më të ultë apo vetëm 78%. Kjo ka ndodhur sepse menaxhmenti nuk ka bërë analiza në baza të rregullta periodike mbi ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara.

Rreziku Ekzekutimi i ultë i buxhetit për investime kapitale mund të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ultë i tij rezultojnë me më pak projekte të realizuara për qytetaret apo rrezikojnë arritjen e plotë të objektivave të synuara nga komuna.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e pranuar nga komuna e Lipjanit në 2018 ishin në vlerë 1,804,589€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	2,108,547	1,936,601	1,804,589	1,611,018	1,808,065
Totali	2,108,547	1,936,601	1,804,589	1,611,018	1,808,065

Komuna e Lipjanit ka realizuar edhe të hyra indirekte 231,739€, ku nga policia 197,884€ nga gjobat e gjykatave 33,855€.

⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Komuna gjate vitit 2018 kishte siguruar të hyra vetjake (nga pranimet e reja, të barturat dhe të hyrat indirekte) 2.507 milion € të cilat ishin shpenzuar në vlerë prej 1.519 milion € ndërsa të hyrat e mbetura (të pa shpenzuara brenda vitit) për bartje në vitin e ardhshme ishin rreth 988 mijë eurove.

Çështja B1 – Parregullsi në kalkulimin e të hyrave për tatimin në pronë

Gjetja Sipas Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.03/L-204⁵ neni 9, “Çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendosë që prona ose njësia e banimit që shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej dhjetëmijë euro (10.000€) nga vlera e tatueshme e pronës”. Nështatë raste tatimpaguesve të njëjtë i janë njohur dy e më shumë prona si banim kryesor, kjo ka ndikuar që të hyrat në këto raste të nënvlerësohen për 120€.

Gjithashtu sipas nenit 7 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204, Kuvendi komunal cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % deri 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: prona rezidenciale, pronë e banuar, pronë komerciale, pronë industriale etj. Bazuar në Rregulloren komunale mbi caktimin e tarifave neni 2, komuna në një rast kishe aplikuar gabimisht tarifën tatimore duke mbivlerësuar obligimin tatimor prej 163.35€, pasi ka aplikuar tarifën 0.30% për pronat komerciale, ndërsa sipas dëshmimeve kjo ishte pronë industriale/ depo, që duhej të tarifohet më ulët apo 0.20%.

Kjo si pasojë e angazhimit të anketuesve jo profesionale në teren për verifikimin e gjendjes ekzistuese të pronave, krahasuar me të dhënat në sistem dhe pakujdesisë së zyrtareve të angazhuar për regjistrimin dhe përditësimin e këtyre të dhënave në bazë të informatave faktike.

Rreziku Ngarkesat e pasakta të tatimit në pronë rezultojnë me më pak fonde për komunën dhe dëmtojnë tatimpaguesin në rastet e mbivlerësimit të obligimit tatimor.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të kërkojë që gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes ndryshimeve fizike që ndodhin dhe regjistrimit të pronave të reja po edhe ndryshimet në kategorinë e pronave dhe shfrytëzimin e tyre sipas kategorizimit ligjor. Kjo duke aplikuar anketim profesional dhe ndryshim me kohë të të dhënave në bazë të gjendjes faktike dhe rregullave në fuqi.

⁵ Nga 01 tetor 2018 ka hyrë në fuqi ligji Nr.06/L-005

Çështja B2 - Informata jo të sakta dhe mungesë e dëshmive në dosjen e tatimpaguesve

Gjetja Sipas nenit 14 të UA nr.03/2011 me rastin e regjistrimit të të dhënave në sistem, nga operatorët merren këto të dhëna: numri i ndërtesës, numri i njësisë dhe numri i tatimpaguesit. Pesë nga gjashtë rastet e testuar, në bazën e të dhënave për tatimin në pronë, tatimpaguesit janë identifikuar me më shumë se një numër identifikues, për shkak të regjistrimit të dy ose më shumë pronave. Kjo ka vështirësuar konfirmimin e zbritjes prej 10,000€ për banim kryesor, si dhe ka rritur në mënyrë fiktive numrin e tatimpaguesve në sistem.

Gjithashtu neni 5.8 i po të njëjtit udhëzim parasheh që dosjet e tatimpaguesve të përmbajnë edhe fotografitë e objekteve. Në katër raste në dosjen e tatimpaguesve mungonin fotografitë e pronave.

Kjo për shkak të mungesës së rishikimit të të dhënave ekzistuese nga zyrtari përgjegjës për tatimin në pronë, të dhëna të cilat nuk janë verifikuar, konfirmuar me rastin e futjes në sistem.

Rreziku Dobësitë në sistem dhe mungesa e dëshmive në dosjen e tatimpaguesve nuk ofron një gjendje reale të pronave të tatueshme dhe vështiroshen edhe kalkulimin e drejt të tatimit.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e tatimit në pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuara, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e këtij plani duke mundësuar eliminimin e mangësive dhe pasqyrimin e të dhënave të sakta për pronën e tatueshme.

Çështja A1 - Vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore

Gjetja Neni 17 i Ligjit Nr. 04/L-110 Për Ndërtime, përcakton procedurat dhe afatet kohore për lëshimi e lejeve ndërtimore. Lëshimi i lejes ndërtimore kalon nëpër dy faza; Faza I: organi kompetent parasheh kushtet ndërtimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kërkesës për kushtet ndërtimore për ndërtimet e kategorisë I dhe tridhjetë (30) ditë për ndërtimet e kategorive II dhe III; dhe Faza II: leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe dyzet e pesë (45) ditë për kategoritë II dhe III. Nga pesë mostrat e audituar, katër⁶

⁶ Tek aplikuesi me numër të vendimit për leje ndërtimore 08-351-64147" dhënia e kushteve ndërtimore është bërë pas 70 ditësh, tejkallim i afatit ligjor për 40 ditë. Te aplikuesi me numër të vendimit të LN 8-351-9058 dhënia e kushteve ndërtimore është bërë 51 ditë pas aplikimit apo me 21 ditë vonesë, kurse dhënia e lejes ndërtimore 163 ditë pas aplikimit për leje apo 118 ditë vonesë. Dhënia e kushteve tek 08-351-69256 është bërë pas 94 dite apo 64 ditë vonesë. Dhënia e kushteve ndërtimore për personin fizik 8-351-34671 ka zgjatur 36 dite ndonëse sipas ligjit parashihet të kryhet brenda 15 ditësh, kurse dhënia e lejes ndërtimore ka zgjatur 46 ditë, me vonesë 16 ditë.

prej tyre kanë rezultuar në vonesa (nga 16-118 ditë vonesa) gjatë përcaktimit të kushteve të ndërtimit dhe lëshimit të lejeve ndërtimore. Këto vonesa kanë ardhur si rezultat i neglizhencës apo pakujdesisë së personave përgjegjës gjatë pranimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve për leje ndërtimore si dhe mos informimi i duhur i aplikantëve për afatin dhe dokumentacioni e nevojshëm që duhet ta sjellin.

Rizik Neglizhenca e komunës për respektimin e afateve ligjore rrit rrezikun e arkëtimit të këtyre të hyrave sipas parashikimeve dhe komuna i ekspozohet rrezikut për tu paditura nga qytetar për shkak të vonesave. Gjithashtu kjo mund të rezultojë edhe me ndërtimin jo legal të objekteve për shkak të vonesave në shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të kërkojë raport me shkrim nga Drejtoria e Urbanizimit për çdo tejkalim afati gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore bashkangjitur me arsyetimin për vonesat eventuale me qëllim të monitorimit dhe pajisjes me kushte/ leje ndërtimore brenda afatit të paraparë ligjor.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Buxheti final i kësaj kategorie ishte në shumën 9,095,983€ ndërsa realizimi 9,036,804€ apo rreth 99% të asaj që është buxhetuar.

Në bazë të organizimit të përgjithshëm të personelit në administratën shtetërore, procesi i menaxhimit është i decentralizuar dhe procedurat kryhen në mënyrë të pavarur nga secili institucion.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, komunal në vitin 2018 ishte 1,588,980€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,355,192€ apo rreth 85% e asaj që ishte planifikuar. Pjesa me e madhe e shpenzimeve ishte e orientuar nga shpenzimet për "Shërbime kontraktuese tjera", "Rrymë", "Dru" si dhe "Vendime Gjyqësore", të cilat janë raportuar te nënkapitulli i opinionit të auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 404,996€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 336,750€ apo rreth 83%. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve publike si dhe pagesa për përfituesit individual.

Çështja A2 - Raportet kthyesë për përfitim të subvencioneve

Gjetja Neni 28 i Rregullores komunale për subvencione, kërkon që pas 30 ditësh të përfitimit të subvencionit përfituesit obligohen që të sjellin raporte financiare dhe narrative në komune lidhur me shpenzimin e subvencionit.

Komuna nuk kishte pranuar raport kthyes nga përfituesi, për mbështetjen financiare ndërtimin e shtëpisë në vlerë prej 1,500€ të ndara nga komuna me 12.09.2018. Ndërsa në një rast tjetër, komuna kishte ndarë mjete në vlerë prej 470€ për organizimin e programit artistik, përderisa përfituesi nder të tjera kishte sjelle dëshmi për pagesën e mirëmbajtjes bankare prej 70€, shpenzimi që nuk ishte paraparë në kërkesën për buxhet në projekt propozimin e organizatorit. Kjo kishte ndodh për shkak të pamundësisë për të monitoruar subvencionet e dhëna.

Rreziku Mungesa e dëshmimeve apo raporteve kthyes dhe mungesa e kontrolleve rrit rreziku që mjetet e komunës, të dedikuar përfituesve të subvencioneve të kenë arritur destinacionin/ qëllimin për të cilin janë dhanë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të monitoroj zbatimin e rregullores duke kërkuar nga drejtorit përkatëse/personat përgjegjës të sigurohen vetëm nëpërmes pranimin të dëshmimeve kthyesë, se mjetet kanë arritur qëllimin për të cilin janë ndarë. Në rast se përfituesit nuk arsyeton shpenzimin e subvencioneve apo përdorimi i mjeteve nuk është në përputhje me vendimin atëherë të ndërmerren hapat për kthimin e mjeteve në llogarinë e komunës.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,093,192€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 4,174,662€ apo rreth 82% e asaj që është planifikuar. Ato kanë të bëjnë me “Ndërtimin e Rrugëve Lokale” “Objekte Arsimore” “Objekte Sportive” etj.

Çështja C3 – Aneks kontrata, pa autorizimet e duhura

Gjetja	<p>Sipas nenit 61.23 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA dhe zotimit të mjeteve për kontratën e amandamentuar.</p> <p>Komuna kishte nënshkruar aneks kontrate në katër⁷ raste pa aprovimet e ZKA.</p> <p>Gjithashtu, në tetë⁸ raste zyra e prokurimit kishte zgjatur afatin për përfundime të punëve, pa aprovimet e duhura nga ZKA.</p> <p>Vlerësimi i dobët i nevojave gjatë hartimit të projekteve, ekzaminimi i dobët i kushteve fizike si dhe vonesa në ekzekutimin e punimeve ishin shkaktar të nënshkrimit të këtyre anekseve. Anashkalimi i aprovimit sipas rregullave ishte rezultat i neglizhencës dhe mungesës së kompetencës së menaxherëve të projekteve dhe menaxherit të prokurimit.</p>
Rreziku	<p>Mangësitë në menaxhimin e kontratave rrisin pasigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e parapara. Njëherë mos aprovimi i ndryshimeve-aneks kontratave nga ZKA paraqet mosrespektim të rregullave të prokurimit.</p>

⁷ Vlera e aneks kontratës është 8,123€, kontrata bazë “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shalë”; Vlera e aneks kontratës është 6,822€, kontrata bazë “Asfaltimi rrugicave në lagjet e fshatit Gadime e Epërme”; Vlera e aneks kontratës është 2,926.72€, kontrata bazë “Ndërtimi i shkollës së mesme fillore të ulët në fshatin Mirenë”; Vlera e aneks kontratës 16,970.88€, kontrata bazë “Ndërtimi i shkollës fillore në Rubovc faza II”.

⁸ “Asfaltimi i Rrugës Në Fshatin Sllovi” Afati Ishte Zgjatur për 8 Ditë” Salla E Sportit Në Fshatin Dobrajë e Madhe” (109 Ditë) “Ndërtimi I Trotuareve Me Ndrichim në Fshatin Banulle” (43 Ditë). “Ndertimi I Shkolles Fillore në Rubovc Faza II” (202 Ditë), “Mirëmbajtja Investive, Riparimi I Nyejve Sanitare në Shkollat-Topliqan, Gracke, Shale & Bance” (26 Ditë), “Ndërtimi I Trotuareve Me Ndrichim Publik në Banulle Rruga Livadhet E Thata” (104 Ditë), “Përfundimi I Punimeve-Salla E Sportit Shf. Dobraje E Madhe” (198 Ditë), “Asfaltimi i Rrugës Luftëtare E Lirisë Në Fshatin Babush”(59 Ditë).

Rekomandimi C3 Kryetari të sigurojë se para inicimit të prokurimit për punë, projektet e hartuar paraprakisht janë të studiuara dhe përmbushini të gjitha kërkesat dhe qëllimin që duhet arritur, duke eliminuar mundësin e punëve të pa parashkrua apo vonesave. Nëse paraqitet nevoja për proceduar të aneksimit të kontratave apo vazhdimin të afateve për përfundimin e punëve, aprovimi të behët vetëm nga personi përgjegjës apo Zyrtari kryesor administrativ.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A3- Specifikimi teknik jo i qartë dhe pozicione të përsëritura

Gjetja

Neni 28.7 i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) thekson që “Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi” gjithashtu neni 28.8 “Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t’i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën”. Me rastin e zhvillimit të procedurave për tenderin “Furnizimi me material të imët për mirëmbajtje të shkollave dhe ambulanteve” në vlerë 87,185€ hartimi i specifikoni nuk është bërë në harmoni me kërkesat ligjore, pasi që brenda specifikimit teknik ka pozicione të përsëritura⁹ si dhe referime të artikujve të veçantë¹⁰. Gjithashtu vërehen edhe përshkrime të paqarta të pozicioneve¹¹, që nuk hyjnë në përdorim apo nuk kanë të bëjnë me natyrën e mirëmbajtjes së objekteve.

Komuna për hartimin e projekteve të kanalizimeve, rrugëve, ujësjellësve, planeve zhvillimore-urbane, kishte lidhur kontratë publike kornizë më 22.02.2016. Kontrata përmban 31 pozicione, për të cilat OE i shpërblyer me kontratë ka ofertuar me 0.001€ për 30 pozicione dhe vetëm në një pozicion ka ofertuar me 2.80€. Dosja e tenderit kishte paqartësi tek specifikimet teknike, për elaboratet gjeodezike nga OE është kërkuar të ofertojnë çmim sipas përshkrimit për hektar dhe për metër gjatësi, por pa qartësuar/ specifikuar se kur dhe ku në cilat raste munde të përdoren këto dy pozicioni. Për këto pozicione OE i shpërblyer me kontratë, ka ofertuar 0.001€ për hektar kurse për metër gjatësi

⁹ “Siguresa automatike 20A”; “Gur i brusalicës të madhe por pa përcaktuar diametrin, kurse në pozicionin paraprak gurë brusalicës 350x2.8x25.4”.

¹⁰ Përdorimi i emrit tregtar Fasad X-fort, që është markë tregtare e fabrikës për prodhimin e llaqrave.

¹¹ “Elektroda 1/100” apo “Elektroda 2.5”, “Gozhda Ø15 cm”.

2.80€, ndërkaq për shtatë projektet, çmimi i faturuar për pozicionin elaboratet gjeodezike në të gjitha këto raste është kalkuluar me 2.80€.

Kjo ka ndodhë për shkak të funksionimit jo efikas të kontrollit në zyrën e prokurimit që para se të përgatitet dosja e tenderit të bëhet kontrolli i specifikacionit me qëllim që të shmangen të gjitha paqartësitë. Gjithashtu edhe mungesa e kompetencës profesionale nga njësia kërkuese ka rezultuar me mangësi në hartimin e specifikacioneve teknike.

Rreziku

Pozicione e përsëritura dhe pozicione të paqarta bën që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund ta ndikon ofertën financiare dhe çmimin e kontratës. Gjithashtu kontraktimi i produktit të njëjtë me dy çmime tëndryshme, ka krijuar mundësi që OE të faturojnë me çmim më të lartë duke rritur rrezikun e dëmtimit të buxhetit komunal për shkak të këtyre pagesave.

Rekomandimi A3 Përmes njësisë kërkuese duhet të sigurohet se hartimi i specifikimeve teknike me rastin e tenderimit janë të qarta dhe sipas nevojave reale dhe zyra e prokurimitë forcoj kontrollin duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione të përsëritura apo jo të qarta.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna gjatë vitit 2018 ka prezantuar pasuri kapitale (mbi 1,000) në vlerë prej 165,376,617€ dhe pasuri jo kapitale (nën 1,000€) në vlerë 328,780€. Gjatë vitit, pagesat nga kategoria e investimeve kapitale janë ekzekutuara në vlerë 4,174,662€, ndërsa pasuria e regjistruar ishte 6,776,585€. Diferenca në mes të pasurisë së regjistruar dhe investimeve kapitale qëndron për faktin komuna ka regjistruar si pasuri disa investime në vijim, pastaj donacionet dhe pranimet nga palët e treta.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Lipjanit në fillim të vitin 2018 kishte të llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë 3.97mil € ndërkaq vlera e prezantuar në fund të vitit është 4.34mil €. Të ngjashme si me vitin paraparak ishin LLA nga Lejet Afariste dhe Shpronësimi ndërkaq rritja e të arkëtueshmeve është pasojë e mos inkasimit të rregullt të të hyrave nga tatimi në pronë.

Çështja A4 - Vonesa në arkëtimin e të hyrave.

Gjetja Komuna ka të lidhura dy¹² kontrata për menaxhimin e tregjeve në vlerë prej 12,345€, ku parashihet që operatori ekonomik duhet ti dorëzojë mjetet e grumbulluara në llogarinë e komunës çdo të martë deri në ora 12. Bazuar në dëshmitë e ofruar, komuna nuk ka pranuar mjetet nga operatori ekonomik sipas afatit të përcaktuar në kontratë, duke shkaktuar vonesa me muaj për pranimin e këtyre mjeteve. Edhe pse komuna kishte dorëzuar disa herë vërejtje me shkrim, mirëpo operatori ekonomik ka vazhduar të jetë i pa përgjegjshëm në realizimin e obligimeve.

Rreziku Mungesa e aktiviteteve shtesë ose masave për respektimin/ndërprerjen e kontratës nga ana e komunës rezulton me arkëtim të ulët të të hyrave dhe rritje të llogarive të arkëtueshme. Arkëtimet i vonuar i të hyrave rezulton me mungesë të fonde apo edhe rrezikon mbledhjen e tyre në të ardhmen për shkak të vjetërsimit.

Rekomandimi A4 Kryetari të siguroj se zyrën e prokurimit është njoftuar nga drejtori e shërbimet publike, lidhur me pengesat në implementimin e kontratës (apo vonesat në arkëtimin e mjeteve komfor afateve të parapara në kontratë), në mënyrë që të merren masa për respektimin e tërësishëm të kontratës apo ndërprerjen e saj sipas dispozitave ligjore.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 156,261€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Komuna.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

¹² Kontratën me nr. të prokurimit 413 016 095 231 për tregun e shitjes së mobileve (1,845€) si dhe kontratën me nr. të prokurimit 613 016 060 221 për tregun e gjelbër, të bagëtive dhe të veturave (10,500€).

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Komuna e Lipjanit në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Komunë në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Komuna ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre. KA gjatë vitit ishte aktiv duke mbajtur takime të rregullta. OB e ka përmbushur kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit

Komuna ka përgatitur planin strategjik në nivel të organizatës, si dhe planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, etj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i raporteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

NjAB gjatë vitit 2018 kishte planifikuar 11 auditimi duke i përfunduar të gjitha dhe ka ofruar 72 rekomandime nga të cilat 38 janë zbatuar.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Të gjitha drejtoritë raportojnë në baza të rregullta dhe raportet e drejtorive janë të publikuara në Web faqen e komunës, gjithashtu komuna kishte caktuar një zyrtar e cila kishte bërë identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut për vitin 2018.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 për Komunën e Lipjanit ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. Komuna e Lipjanit kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tri rekomandime janë të mbyllur të pa zbatuara, shtatë rekomandime janë zbatuar, tri rekomandime ishin në proces dhe dy nuk janë zbatuar ende duke u përsëritur edhe këtë vit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Komuna kishe marre veprimet e duhura për mos përsëritje të gabimeve të njëjta në shpalosjet e të hyrave indirekte dhe obligimeve në PVF, këtë vit rishfaqet problemi lidhur me shpalosjet e LLA.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
2	Planifikim Buxhetor	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të subvencionet dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm 2018.	Gjatë vitit 2018, subvencionet janë realizuar 83% ndërsa Investimet Kapitale 82%.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
3	Planifikim Buxhetor	Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për të planifikuar buxhet të mjaftueshëm krahas detyrimeve/obligimeve që pret komuna të përballet, për të ju dhënë prioritet shlyerjes së këtyre obligimeve me kohë, si dhe të prezantojë drejtë shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe natyrës reale të shpenzimeve.	Nuk është ndërmarrë ndonjë veprim, rekomandim përsëritët edhe gjatë vitit 2018. E gjetura është e raportuare te opinionin e auditimit, e cila ndërlidhet me rekomandimin në PVF.	Rekomandim i pa zbatuar.
4	Të hyrat	Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit të pronave dhe të siguroj se verifikimi i 1/3-ës së tyre bëhet në baza të rregullta vjetore, për të reflektuar gjendjen reale të pronave të tatuara. Rritja e regjistrimit të pronave do të rezultojë me më shumë të hyra	Komuna ka ndërmarr aktivitetet për zbatim të kërkesë për verifikimin e pronave sipas kuotës së paraparë.	Rekomandim i zbatuar.

		komunale si dhe performancë më të mirë buxhetore.		
5	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur sistemet e kontrollit në këtë fushë, duke siguruar që të hyrat vlerësohen sipas rregulloreve përkatëse të aprovuara në kuvendin komunal.	Auditori edhe këtë vit ka gjetur se ekzistojnë problem të ngjashëm në kalkulimin e tatimit në pronë.	Rekomandim i pa zbatuar.
6	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që është ndërmarrë një shqyrtim i kontrolleve në lidhje me menaxhimin e procesit për leje ndërtimi dhe që kontrollet janë ri-dizajnuar për ta adresuar problemin. Proceset e rishikuara duhet të sigurojnë që të respektohet kronologjia e proceseve dhe komuna mos të ofrojë shërbim pa u kryer pagesa.	Bazuar në auditimin e këtij viti konsiderojmë se komuna ka ndërmarr aktivitete për zbatimin e këtij rekomandimi.	Rekomandimi i zbatuar.
7	Menaxhimi i personelit	Kryetari duhet t'i rishikojë shkaqet që kanë reflektuar menaxhim jo të mirë të burimeve njerëzore, dhe të sigurojë se janë dizajnuar kontrollet e duhura në mënyrë që rekrutimet të behën përmes një procesi transparent, konkurrues dhe në pajtim me kërkesat ligjore.	Njësitë përkatëse të personelit kanë filluar në implementim të kërkesave ligjore, në përjashtim të Drejtorisë Komunale të Arsimit të cilët pas ndikimit të MASHT prape nuk realizojnë teste me shkrim me rastin e rekrutimit.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar.
8	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet komunale	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në procesin e prokurimit, në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Gjatë procesit të planifikimit duhet të behën analiza të mjaftueshme mbi nevojat për mallra dhe shërbime dhe të aplikojë procedura të hapura të prokurimit. Tutje të sigurojë që blerjet të behen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme.	Komuna ka ndërmarr masa për respektimin e kërkesave.	Rekomandim i zbatuar.
9	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë respektimin konsistent dhe efektiv të rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave, dhe të sigurohet që vlerësimi i tenderëve dhe shpallja e fituesve është në përputhje me kriteret e vendosura dhe ligjin e prokurimit publik.	Janë marrë masat e nevojshme për mos shpërblim me kontrate të operatoreve të pa përgjegjshëm mirëpo, edhe këtë vit përsëriten ndryshime të pa autorizuara në para masë dhe parallogarit.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.

10	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të siguroj kontrolle shtesë në procesin e prokurimit, në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Më tutje të sigurojë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet e mjaftueshme para hyrjes në obligime kontraktuale.	Auditori konsideron se është respektuar kërkesa për zotimin e mjeteve para hyrjes në obligime kontraktuale.	Rekomandim i zbatuar.
11	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet janë efektiv në zbatimin e proceduarve të prokurimit dhe menaxhimin e kontratave, dhe aplikoj masa për ndarje të duhur të detyrave në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.	Rekomandimi është zbatuar, auditori nuk ka gjetur ndonjë raste ku ka ndarje jo të drejt të detyrave.	Rekomandim i zbatuar.
12	Llogarit e Arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për verifikimin dhe azhurnimin e të dhënave nga tatimi në pronë, për të siguruar që lista të jetë e përditësuar me të dhëna aktuale, pastaj të merr të gjitha veprimet e nevojshme për të azhurnuar të dhënat para përfundimit të vitit financiar 2018.	Informatat në programin e menaxhimit të tatimit në pronë, kanë ende nevoje për tu plotësuar si dhe konfirmuar, probleme të ngjashme përsëriten edhe këtë vit.	Rekomandim i mbyllur dhe i pa zbatuar (fuzionohet tek çështja B1).
13	Obligimet e pa paguara	Kryetari duhet t'i rishikojë kontrollet mbi procesin e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve, si dhe prezantimit të tyre në raportet mujore të obligimeve të papaguara, përfshirë edhe shpалosjen e tyre në PFV. Gjithashtu duhet t'i identifikojë arsyet për mos ofrimin të dokumentacionit, si dhe siguroj mundësi me të mira të bashkëpunimit/ofrimit të dokumentacionit për realizim sa me përshtatshëm të auditimit sipas kërkesave ligjore në fuqi.	Komuna i ka aplikuar kërkesat lidhur me kontrollet mbi procesin e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve.	Rekomandim i zbatuar.
14	Progresi i zbatimit të rekomandimeve	Kryetari duhet konsideroj aktivitete shtesë për të siguruar që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, monitorohet nga një grup i caktuar në nivel të Komunës, dhe raportohet në baza të rregullta kohore në lidhje me progresin dhe sfidat në zbatimin e tyre.	Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tri rekomandime janë të mbyllur, shtatë rekomandime janë zbatuar; tri rekomandime ishin në proces dhe dy nuk janë zbatuar ende duke u përsëritur edhe këtë vit.	Rekomandim i mbyllur dhe i pa zbatuar

15	Raporti mi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, duhet të siguroj se planifikohen dhe ndërmerren masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Drejtoritë raportojnë te ZKA në baza të rregullta kohore dhe raportet e drejtorive janë të publikuara në Web faqen e komunës.	Rekomandim i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Të gjitha shpenzimet duhet të buxhetohen dhe evidentohen në përputhje me planin kontabël dhe të ofrohen shpalosje të sakta për llogarit e arkëtueshëme.		
2	Planifikim dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë se është ndërmarrë një vlerësim sistematik të shkaqeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit të investimeve kapitale dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij në vitin e ardhshëm.		
3	Të Hyrat	Kryetari duhet të kërkojë që gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të pronave ti kushtohet kujdes ndryshimeve fizike që ndodhin dhe regjistrimit të pronave të reja po edhe ndryshimet në kategorinë e pronave dhe shfrytëzimin e tyre sipas kategorizimit ligjor. Kjo duke aplikuar anketim profesional dhe ndryshim me kohë të të dhënave në bazë të gjendjes faktike dhe rregullave në fuqi.		
4	Të Hyrat	Kryetari duhet të kërkojë nga Zyra e tatimit në pronë një plan të detajuar afatmesëm për të eliminuar dobësitë e identifikuara, dhe ta mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e këtij plani duke mundësuar eliminimin e mangësive dhe pasqyrimin e të dhënave të sakta për pronën e tatueshme.		
5	Të Hyrat.	Kryetari duhet të kërkojë raport me shkrim nga Drejtoria e Urbanizimit për çdo tejkallim afati gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore bashkangjitur me arsyetimin për vonesat eventuale me qëllim të monitorimit dhe pajisjes me kushte/ leje ndërtimore brenda afatit të paraparë ligjor		
6	Subvencionet dhe transfere	Kryetari duhet të monitoroj zbatimin e rregullores duke kërkuar nga drejtorit përkatëse/ personat përgjegjës të sigurohen vetëm nëpërmes pranimit të dëshmimeve kthyesë, se mjetet kanë arritur qëllimin për të cilin janë ndarë. Në rast se përfituesit nuk arsyeton shpenzimin e subvencioneve apo përdorimi i mjeteve nuk është në përputhje me vendimin atëherë të ndërmerren hapat për kthimin e mjeteve në llogarinë e komunës.		

7	Investimet kapitale.	Kryetari të siguroje se para inicimit të prokurimit për punë, projektet e hartuar paraprakisht janë të studiuara dhe përmbushini të gjitha kërkesat dhe qëllimin që duhet arritur, duke eliminuar mundësin e punëve të pa parashkrua apo vonesave. Nëse paraqitet nevoja për proceduar të aneksimit të kontratave apo vazhdimin të afateve për përfundimin e punëve, aprovimi të behët vetëm nga personi përgjegjës apo Zyrtari kryesor administrativ.
8	Çështjeje e përbashkëta për mallra, shërbime dhe investime kapitale.	Përmes njësive kërkuese duhet të sigurohet se hartimi i specifikimet teknike me rastin e tenderimit janë të qarta dhe sipas nevojave reale dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione të përsëritura apo jo të qarta.
9	Llogarit e arkëtueshme.	Kryetari të siguroj se zyrën e prokurimit është njoftuar nga drejtori e shërbimet publike, lidhur me pengesat në implementimin e kontratës (apo vonesat në arkëtimin e mjeteve komfor afateve të parapara në kontratë), në mënyrë që të merren masa për respektimin e tërësishëm të kontratës apo ndërprerjen e saj sipas dispozitave ligjore.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmim



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Të nderuar,
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Lipjanit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës,
Data: 20.Maj.2019, Lipjan,

